

## KONTRATE DHURIMI TE AKSIONEVE

Sot më datë 30/09/2020 (dymije e njetete), ne seline e shoqerise A.I.B.A KOMPANI sh.a, Rr. "Tirana" Lagjia nr.14, Shkozet, Durres, u paraqitën personalisht,

### **PALËT:**

**Z. Armand Duka**, shtetas shqiptar, lindur ne Durres, me 07-10-1962, banues ne Durres, identifikuar me Pasaporte nr. BR4361798 (*këtu e më poshtë në këtë kontratë referuar si "DHURUESI I AKSIONEVE"*)

dhe

**Z. Andi Duka**, shtetas shqiptar, lindur ne Durres, me 14.03.1992, banues ne Durres, me pasaporte nr. BB7100020,

**Zj. Enva Duka**, shtetase shqiptar, lindur ne Durres, me 23.12.1988, banues ne Durres, me pasaporte nr. BI8718436, (*këtu e më poshtë në këtë kontratë referuar te dy si "PRANUESIT E DHURIMIT"*)

Kjo kontratë dhurimi aksionesh eshte lidhur duke patur parasysh vullnetin e lire dhe te plote te palëve për transferimin e aksioneve të shoqërisë tregatre A.I.B.A KOMPANI Sh.A.

Sa më sipër, palët ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës me termat si më poshtë vijon :

### **MEQËNËSE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE**

Shoqëria Tregtare "A.I.B.A KOMPANI Sh.A. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), është një shoqëri aksionere, e cila ka fituar personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar me numër identifikimi NIPT J61818528J. Shoqëria ka një kapital prej 144.500.000,00 të regjistruar, nënshkruar dhe derdhur, në vlerën e shlyer prej 144,500,000.000 (njqind e dyzet e kater milion e peseqindmije) lek, me numer aksione 34.000,00 (tridhjetë e kater mije), me vlerë nominale të një aksioni prej 4.250,00 (kater mije e dyqind e pesedhjetë) lek, e zotëruar nga 100%



te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise aksioneri i vete z. Armand Duka, sipas Ekstraktit te Qendres Kombetare te Biznesit.

Dhuruesi i aksioneve në këtë kontratë, z. Armand Duka, me vullnetin e tij te plote dhe te lire, dhe sipas marreveshjeve paraprake të palëve, ka vendosur të transferojë nje pjese te aksioneve qe ai zoteron tek pranuesit e dhurimit, perkatesisht:

- **Z. Andi Duka** do te perfitoje 25% te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise;
- **Z. Enva Duka** do te perfitoje 25% te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Pranuesit e Dhurimit në këtë kontratë, shtetasi Z. Andi Duka, është dakort te pranoje dhurimin prej ne masen prej 25% të aksioneve qe zoteron aksioneri z. Armand Duka në kapitalin te Shoqërisë. Pranuesi i Dhurimit ne kete kontrate, person fizik Zj. Enva Duka, është dakort te pranoje masën prej 25% të aksioneve qe zoteron aksioneri z. Armand Duka ne kapitalin te Shoqërisë.

Nëpërmjet realizimit të këtij veprimi juridik, pranuesit e dhurimit do të fitojnë, secili cilësinë e aksionerit të Shoqërisë sipas perqindjes se aksioneve qe do te perfitojne.

Dhuruesi z. Armand Duka, pas transferimit te aksioneve tek pranuesit e dhurimit do te mbetet zoterues i 50% te aksioneve ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Kjo Kontrate vendos termat dhe kushtet sipas së cilave Dhuruesi do të transferoje dhe pranuesi i dhurimit do të pranojne AKSIONET që janë objekt i termave dhe kushteve të kësaj Kontrate:

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, PALËT me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, bien dakort si më poshtë:

## NENI 1

### PËRKUFIZIME

Përveç termave të tjera të përkufizuara posaçërisht në ndonjë dispozitë të kësaj Kontrate, për qëllimet të interpretimit dhe zbatimit të saj, fjalët dhe termat që vijojnë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:



2

- a. *"Kontratë"* do të thotë kjo Kontratë për transferimin e Aksioneve nepemjet dhurimit (ne reference neni 117/1/ç te Lighit Tregtar), duke përfshirë si një pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme, të shkëmbyera ndërmjet Dhuruesit dhe pranuesit të dhurimit;
- b. *"Transferimi"* do të thotë dhurimi dhe pranimi i dhurimit të Aksioneve, në përgjithësi, pranimi, nënshkrimi dhe shkëmbimi i gjithë dokumentave të nevojshme, dhe kryerja, përmbushja e gjithë detyrimeve, për Transferimin në përputhje me këtë Kontratë;
- c. *"Data e Transferimit"* do të thotë data në të cilën aksionet janë Transferuar nga Dhuruesi të pranuesi i dhurimit, në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate.
- d. *"Pala"* do të thotë Dhuruesi ose Pranuesi i Dhurimit ose të dy së bashku, siç e kërkon përmbajtja e kësaj kontrate;
- e. *"Shoqëria"* do të thotë shoqëria tregtare A.I.B.A KOMPANI sh.a.
- f. *"Vendim i Shoqërisë"* do të ketë kuptimin e Vendimit të marrë nga organi kompetent i shoqërisë A.I.B.A KOMPANI sh.a, dhe nëpërmjet të cilit është miratuar realizimi i operacionit të transferimit të aksioneve.
- g. *"Pasuri vetjake"* kuptohet si pasuri e fituar individulisht nepermjet dhurimit, e cila nuk do të përfshihet, do të përjashtohet në bashkësinë pasurore të regjimit martesor.

Termat dhe fjalët e përdorura në numrin njëjës në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim dhe në rast se do të përdoren në numrin shumës.

## NENI 2

### OBJEKTI I KONTRATËS

Objekt i kësaj kontrate është transferimi nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë kontratë, 50%, të vlerës së aksioneve në kapitalin themeltar dhe çdo të drejte që u përket këtyre Aksioneve, të lira nga çdo Barrë.

Aksionet që do të transferohen, objekt i kësaj kontrate, përfaqësojnë masën prej 50% të kapitalit të shoqërisë.



Aksionet do të transferohen nepermjet dhurimit nga aksioneri i shoqërise:

- **Z. Armand Duka, do të transferoje 50%, të vlerës së aksioneve në kapitalin fillestar të Shoqërisë që i korespondon kapitalit prej 72.250.000, të barabartë me 17,000 (shtatembedhjete mije) numër aksionesh me kontribut në vlerën 72,250,000 (shtatedhjete e dy milion e dyqind e pesedhjete mije)lekë.**

### NENI 3

#### MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Aksionet e transferuara sipas kësaj kontrate kalojnë në pronësi të pranuesit të dhurimit në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Dhuruesi, humbet pjesërisht pronësinë e aksioneve që zotëron në shoqërinë "A.I.B.A KOMPANI" Sh.a., në masën prej 50% të aksioneve në kapitalin e regjistruar të shoqërisë, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi këtë pjesë.

Ndërsa, Pranuesit e dhurimit Z. Andi Duka, bëhet pronar i masës prej 25% të aksioneve të kapitalit dhe Zj. Enva Duka behet pronar i masës prej 25% të aksioneve të kapitalit duke fituar në të njëjtën kohë dhe cilësinë e aksionerit të shoqërisë A.I.B.A KOMPANI sh.a.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë A.I.B.A KOMPANI sh.a, do të zotërohet në këtë mënyrë:

- Aksioneri z. Armand Duka zotëron masën prej 50% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale 72,250,000 lek, dhe numër aksione 17,000.
- Aksioneri z. Andi Duka, zotëron masën prej 25% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale 36,125,000 lek, dhe numër aksione 8,500;
- Aksioneri Zj. Enva Duka zotëron masën prej 25 % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale 36,125,000 lek, dhe numër aksione 8,500.

### NENI 4

#### DETYRIMET E PALËVE NË LIDHJE ME TRANSFERIMIN



Përveç ndonjë veprimi tjetër për tu ndërmarrë dhe të ndonjë instrumenti tjetër për tu nënshkruar dhe/ose dorëzuar në përputhje me këtë Kontratë, për transferimin e aksioneve:

**a) Dhuruesi do të:**

- i. Dorëzohë të gjithë dokumentacionin ligjor të shoqërisë me të cilin vërtetohen nënshkrimi rregullisht dhe shlyerja e aksioneve të kapitalit themeltar;
- ii. Nënshkruajë dhe dorëzohë dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e instrumentave të tjera që mund të jenë të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, për t'i kaluar pranuesit të dhurimit pronësinë e lirë nga çdo barrë apo pretendim të çdo lloji, qoftë nga persona fizik apo juridike, privatë apo publikë.
- iii. Dorëzohë të gjithë dokumentacionin ligjor dhe financiar të shoqërisë në disponim të kësaj të fundit.

Dhe

**b) Pranuesi i dhurimit do të:**

- i. Do të marrë në dorëzim të gjithë dokumentacionin e shoqërisë sipas pikave i dhe iii të gjurmës a) të këtij neni.

Në përfundim, pranuesi i dhurimit fitojnë titullin mbi Aksionet në datën e Transferimit dhe po në këtë datë do të fitojnë cilësinë e aksionerit të Shoqërisë duke zotëruar secili % (përqindjen) të sipercituar të aksioneve të kapitalit themeltar, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi Aksionet e perfituara.

Dhuruesi dhe Pranuesi i dhurimit zj. Enva Duka, shprehen se ky transferim aksionesh nepermjet dhurimit, ne momentin e fitimit te mases se aksioneve, sa me siper, nuk do e trajtohet si regjim pasuror martesor i bashkesise ligjore, (ne baze te nenit 77/b te Kodit te Familjes). Pra, ky transferim nuk do te jete ne favor te bashkesise ligjore, por pasuri vetjake per pranuesen e dhurimit zj. Enva Duka.

**NENI 5**

5

## DETYRIME SPECIFIKE TË PALËVE

Palët në këtë kontratë deklarojnë se sipas marrëveshjes paraprahe të arritur mes tyre, pranuesit e dhurimit kane fituar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi aksionet e shoqërisë, ne momentin e nenshkrimin të kontrates.

### Neni 6

#### DEKLARIMET DHE GARANCITË E DHURUESIT

Dhuruesi deklaron dhe i garanton pranuesit te dhurimit sa më poshtë;

- a. Shoqëria A.I.B.A KOMPANI SHA është një Shoqëri e organizuar dhe që funksionin në bazë të ligjislacionit Shqipëtar dhe ka dhe kompetencë të plotë për të drejtuar veprimtarinë e saj, të zotërojë pronat dhe aktivet që ka tashmë në zotërim. Shoqëria është licënsuar sipas rregullave në fuqi të kryejë veprimtari sipas objektit të saj të përcaktuar në Statutin e shoqërisë. Dhuruesi garanton se nuk do të ketë asnjë ndryshim në dokumentat ligjor të shoqërisë, përsa i përket akteve të saj të themelimit dhe veprimeve të posaçme në lidhje me lejet apo licënsat përkatëse deri në datën e Transferimit.
- b. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë në datën e transferimit është 144,500.000,00 lek dhe përbëhet nga 34 000 aksione, me vlerë nominale 4,250.00 lekë për çdo aksion. Gjithë Aksionet e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë janë shlyer tërësisht.
- c. Nuk ekziston asnjë vendim gjyqësor i formës së prerë të çdo shkalle gjykimi, vendim administrativ dhe i çdo i qeveritar, për hapjen e ndonjë procedurë falimentimi apo likuidimi.

### NENI 7

#### DEKLARIMET DHE GARANCITË TE PRANUESIT TE DHURIMIT TE AKSIONEVE

Pranuesi i dhurimit deklaron dhe garanton Dhuruesin si më poshtë:

- a. Pranuesi i dhurimit është një person fizik (shtetas) i padënuar asnjëherë, me reputacion dhe aftësi të konsiderueshme në fushën tregtare.



- b. Pranuesi i dhurimit ka fuqi dhe të plotë për të hyrë në këtë Kontratë. Pranuesi i dhurimit ka ndërmarrë gjithë veprimet e nevojshme për të përfunduar këtë Kontratë dhe për të përmbushur detyrimet e miratuara në të.

## NENI 8

### SHPENZIMET DHE TATIMET

9.1 Të gjitha shpenzimet që lidhen me paraqitjen në formën e kërkuar nga ligji të Vendimeve, dokumentave ligjore dhe dokumentave të tjera të cilat i bashkëlidhen kësaj kontrate do të jenë në ngarkim të palës e cila është e detyruar të paraqesë këto dokumenta.

9.2 Shpenzimet tatimore që lidhen me këtë kontratë përsa i përket tatimit mbi të ardhurat (të tatimit mbi transferimin e aksioneve), do të mbulohen nga Pala Dhuruese në këtë kontratë, në konformitet me legjislacionin fiskal shqiptar në fuqi.

## NENI 9

### LIGJI QË DO TË ZBATOHET

#### 10.1. Ligji i Zbatueshëm

Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ndonjë çështje e cila nuk është parashikuar në këtë kontratë do të rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit tregtar dhe parimet e përgjithshme të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

#### 10.3. Zgjidhja e Konfliktëve

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate ose e lidhur me të, apo çdo shkelje që rrjedh prej këtij do t'i nënshtrohet zgjidhjes me mirëkuptim të palëve në këtë kontratë. Në rast se nuk do të arrihet zgjidhja me pajtim, Gjykata kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

## NENI 10

### TË NDRYSHMIE

 7

**11.1. Hurja ne fuqi kontrates**

Kjo Kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit te saj nga palet respektive.

**11.2 Ndryshimi i kushteve kontraktore.**

Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm sipas marrëveshjes së shkruar të përfunduar mes Palëve.

**NENI 11**

**GJUHA E KONTRATËS**

11. Kjo Kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe dhe gjuhën, e përbërë nga 8 (nente) faqe dhe është përgatitur në 4 (kater) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

**PALËT**

**DHURUESI**

**Z. Armand Duka**



**PRANUESI I DHURIMIT**

**Z. Andi Duka**



**Zj. Enva Duka**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE DURRËS

NOTER DIANA F. HOXHA  
ADRESA NR.4/RAJONI 1,  
SKENDERBEJ/EGNATIA, PALLATI  
1182  
TEL: 697879363

# DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 2072

Nr. koleksioni: 1058

Durres më 06/10/2020



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 1 fletë



A2020010900101218575



U LIKUJDU  
TAKSA E PULLES



A2020010900101218575

## DEKLARATË NOTERIALE

Sot, më datë 06.10.2020, para meje Notere DIANA F. HOXHA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4/RAJONI 1, SKENDERBEJ/EGNATIA, PALLATI 1182, u paraqit personalisht:

### DEKLARUES/IT

**Suela Duka**, atësia Ali, amësia Vule, shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banuese në DURRËS, me adresë PETRAQ BOSHNJAKU 00690631; Nd. 19; H. 1; ; DURRËS; DURRËS; 2008; DURRËS, lindur më 02/11/1973, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 030229157 dhe nr. personal H36102110Q, e cila nën përgjegjësinë e saj personale dhe në vullnet të lirë e të plotë, në bazë të nenit 79 të Kodit Civil Shqiptar, nenit 62, 63 , të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, më deklaroi si më poshtë vijon:

### Objekti: Deklarim mbi dakortesine e dhurimit te kuotave

Une deklaruesja znj.Suela Duka, ne cilesine e bashkeshortes ligjore te z.Armand Duka, miratoj dhe jap pelqimin tim mbi aktin Kontrate Dhurimi te Aksioneve date 30.09.2020, lidhur midis transferuesit/Dhurues z. Armand Duka dhe perfituesit/pranues te dhurimit z. Andi Duka dhe znj. Enva Duka.

Une deklaruesja, jam dakort per transferimin e kryer te 50% te aksioneve qe bashkeshorti im z. Armand Duka zoteronte ne shoqerine “A.I.B.A KOMPANI”sh.a, ne favor te perfituesve, sipas Kontrates se Dhurimit te Aksioneve date 30.09.2020.

Une deklaruesja, shpreh vullnetin tim se me perpilimin dhe nenshkrimin e aktin Kontrate Dhurimi te Aksioneve date 30.09.2020, eshte ezauruar cdo e drejte dhe detyrim midis paleve, duke mos patur asnje pretendim te kundert, sot edhe ne te ardhmen.

Deklarata e mësipërme, u hartua në gjuhën shqipe dhe u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të deklaruesit/ses të mësipërme. Pasi ai/ajo deklaroi se u njoh dhe i kuptoi efektet juridike të aktit, e nënshkruan atë rregullisht përpara meje Noteres. Kjo deklaratë, u hartua nga unë Noterja në 6 (gjashte) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të deklaruesit. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale dhe tw tjerat i vihen në dispozicion deklaruesit/ses. Bashkëlidhur deklaratës gjendet dokumentacioni i mëposhtëm: Kopje e mjetit të identifikimit të personit të paraqitur.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tij/saj nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa “II”, të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e deklaruesit/ses. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj deklarate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

### DEKLARUES/IT

Suela Duka

NOTER  
DIANA F. HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERIKETA M. KOKOLI  
ADRESA NR.10, SAMI FRASHERI,  
NR.16  
TEL:

# DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 2064

Nr. koleksioni: 1071

Tirane më 26/10/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020053090098366159



DEKLARATË NOTERIALE

Në Tiranë, sot më datë 26.10.2020 (dy mijë e njëzetë), para meje noteres Euriketa Kokoli; me adresë në Rr. Samir Frashëri, Tiranë, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit:

**DEKLARUESI:** “BANKA e TIRANËS” SH.A, me adrese: Rr. “Ibrahim Rugova”, Tirane, shoqeri e krijuar qe vepron si person juridik ne baze te ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.12718, date 03.11.1995, NIPT J61924008V, si dhe me Licensen Nr.07, date 12.09.1996 te leshuar nga Banka e Shqiperise, e perfaqesuar ketu e me poshte nga **Drejtores e Divizionit të Korporatave, znj. Glenda Kurti**, e bija e Agronit, lindur me 06.03.1978, ne Tirane dhe banues ne Tirane ne adresen Rr. “Kongresi i Manastirit”, Pall. ½, Shkalla 3, identifikuar me pasaporte Nr. H85306150N dhe nga **Drejtores e Administrimit të Kredive, Aida CENGU**, e bija e Azemit, lindur me 16.02.1970 ne Kukes dhe banuese ne Tirane, me leternjoftim Nr.035236532 dhe Numer personal H05216129L, te dy madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar të dy madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët deklaruan sa më poshtë vijon:

**Shoqëria “BANKA e TIRANËS” SH.A, i ka akorduar Kredimarresit shoqërisë “A.I.B.A KOMPANI” sh.a (NUIS J61818528J) disa kredi bankare sipas:**

- a) Kontratë për Kredi Afat Gjat Nr.CO.920/05.07.2019 ndryshuar me Shtojcë Kontratë për Kredi Afat Gjatë Nr. CO.920/1/12.12.2019, një kredi në shumën prej EUR 1,200,000 (një milion e dyqind mijë euro);
- b) Kontratë për Kredi Afat mesëm Nr.CO.921/05.2019, ndryshuar me Ndryshim Kontratë për Kredi Afat Mesëm në Kontratë për Dhënie Kredie Bankare në një Llogari Rrjedhëse (Overdraft) Nr.CP.921/19.07.2019, ndryshuar me Shtojcë Kontratë për Dhënie Kredie Bankare në një Llogari Rrjedhëse (Overdraft) Nr. CO. 921/1/12.12.2019, një kredi në shumën prej EUR 866,568 (tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro).

Per te siguruar shlyerjen e këtyre kredive, është vendosur barrë siguroese dhe peng ne favor te “BANKA e TIRANES” Sh.A mbi aksionet që zotëron z.Armand Duka në kapitalin e shoqërisë “A.I.B.A KOMPANI” sh.a (NUIS J61818528J) si më poshtë:

- (i) 34,000(tridhjetë e kater mije) aksione (pjesëve të kapitalit) me vlerë nominale 4,250 Lekë (kater mije e dyqind e pesedhjetë lekë) secila, të zotëruara prej Barrëdhënësit në kapitalin e shoqërisë “A.I.B.A KOMPANI”SH.A (NUIS Nr.J61818528J) dhe që përfaqësojnë 100% të kapitalit të kësaj shoqërie; si dhe
- (ii) çdo aksion të ri të shoqërisë “A.I.B.A KOMPANI”SH.A që mund të fitohet në të ardhmen prej Barrëdhënësit nëpërmjet kapitalizimit të fitimeve, rritjes së kapitalit etj.; si dhe
- (iii) të gjitha të drejtat që rrjedhin në çdo mënyrë, direkt ose indirekt, nga zotërimi i Kolateralit, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në të drejtën e dividendëve (fitimeve) dhe të drejtën e votimit në asamblenë e aksionarëve lidhur me Kolateralin;

Kjo vërtëtohet me Marrëveshjen Siguruese me Nr. 2841Rep e Nr. 1772Kol, date 20.12.2019 te noteres Diana HOXHA si dhe Kontratës së Pengut mbi Aksionet me Nr. 2840Rep/Nr. 1771Kol datë 20.12.2019 të noteres Diana HOXHA, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me datë 09.01.2020.

Meqenese mbi 34,000 (tridhjetë e katër mijë) aksione pjesë të kapitalit me vlerë nominale 4,250 Lekë (katër mijë e dyqind e pesëdhjetë lekë) secila, të zotëruara nga z.Armand DUKA në kapitalin e shoqërisë "A.I.B.A KOMPANI" sh.a (NUIS J61818528J) dhe që përfaqësojnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të kësaj shoqërie është vendosur barrë siguruese dhe peng ne favor te "BANKA e TIRANES" SH.A, me kete deklarate ne japim pelqimin per kalimin e pronesise vetëm mbi 50 % (pesëdhjetë përqind) të aksioneve dhe konkretisht:

- a) 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit që z.Armand DUKA zoteron tek shoqëria "A.I.B.A Kompani" sh.a do të kalojë tek Pranuesi i Dhurimit z.Andi DUKA me kushtin që mbi këto aksione të vazhdojnë të qëndrojnë të rënduara me peng dhe barrë siguruese ne favor te "BANKA e TIRANES" Sh.a;
- b) 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit që z.Armand DUKA zoteron tek shoqëria "A.I.B.A Kompani" sh.a do të kalojë tek Pranuesja e Dhurimit znj.Enva DUKA me kushtin që mbi këto aksione të vazhdojnë të qëndrojnë të rënduara me peng dhe barrë siguruese ne favor te "BANKA e TIRANES" Sh.a;

Pra, kalimi i pronësisë së aksioneve në masën prej 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të zotëruara nga z.Armand DUKA ku konkretisht në pronësi të z.Andi Duka do te kalojë 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit dhe në pronësi të znj.Enva Duka do të kalojë 25% (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit duhet te behet se bashku me barren siguruese/pengun ne favor te "BANKA e TIRANES" Sh.a dhe pa cenuar te drejten e saj.


Gjithashtu, ne japim pelqimin tone per kryerjen e veprimeve perkatese nga Zyra e Noterise dhe Qendra Kombëtare e Biznesit.

Kjo Deklaratë Noteriale u përpilua nga unë Noteri në 5 (pesë) origjinale konform vullnetit të lirë të Deklaruesve, të cilëve pasi ju lexua me zë të lartë dhe pasi e gjetën sipas vullnetit të tyre, e nënshkruan rregullisht para meje NOTERIT.

#### DEKLARUES

"BANKA e TIRANËS" SH.A.  
përfaqësuar nga:

  
Drejtores e Divizionit të Korporatave

  
Drejtores e Departamentit të Administrimit të Kredive

NOTERE